



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 123 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 30 / 08 / 2023

VENDIM

Nr. 31, date 30 / 08 / 2023

PËR

PROJEKT IDENË E OBJEKTIT

“RIKONSTRUKSIONI I DIGËS SË REZERVUARIT TUFINË”, TIRANË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave” dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 “Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 30.08.2023 mori në shqyrtim Projekt Idene e paraqitur nga Bashkia Tirane për Rikonstruksionin e Digës së Rezervuarit të Tufinës e cila administrohet nga kjo Bashki. Kjo digë me lartësi 23 m është ndërtuar në vitin 1965 dhe ka më se 15 vjet që është jashtë funksionit për shkak të kushteve të vete trupit të digës si dhe humbjes së funksionit të qëllimit kryesor për të cilin është ndërtuar. Në dokumentacionin e paraqitur nuk jepet asnjë dokumentacion në lidhje me pronesinë dhe autoritetin e shfrytëzuesit të digës.

Ky projekt është përgatitur nga firma konsulente Dekliada shpk. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se **projekti nuk i ka plotësuar kërkesat e nenit 5 të ligjit të mesipër si dhe të nenit 8 të VKM së mesipërme** në lidhje me raportin e firmës këshilluese, licencat e bashkëpunuesve të projektit, firmosjen e projektit nga Bashkia e Tiranës, vlerën e punimeve të parashikuara, etj. Raporti mbështetës për studimin sizmik, duhet të plotësohet me autore dhe licencat perkatese, kurse raportet gjeologjike dhe gjeoteknike nuk janë të plota dhe në përputhje me kërkesat e shprehura në Vendimin e KKDM Nr. 15, datë 15.02.2021. Në dokumentacionin e paraqitur nuk është bërë një analizë e plote në lidhje me gjendjen e materialit të trupit të digës i cili në shumë vende ka rreshqitje të mëdha dhe paqëndrueshmëri të theksuar. Firma konsulente nuk ka marrë në konsideratë konkluzionet e studimit të kryer në vitin 2009 nga Banka Botërore e cila konstaton se kjo digë ka mjaft probleme në lidhje me qëndrueshmërinë e saj dhe një rrezik të madh për zonën urbane poshtë saj. Gjithahstu, nga informacioni i MBZHR rezulton se kjo digë e ka humbur qëllimin për të cilin është ndërtuar duke qenë se poshtë saj nuk ka asnjë ha tokë bujqësore që të ujitet por vetëm zonë urbane e cila është në rrezik nga ndonjë prishje e mundshme e saj. Projekt ideja e paraqitur nuk e ka analizuar versionin e masave mbrojtëse dhe rregulluese të zonës në kushtet e një abandonimi të kësaj digë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur mungojnë të dhënat për matjet batimetrike, sistemet e monitorimit, vlera e punimeve që duhet të kryhen, vendi i karrieraeve që do të përdoren, informacion në lidhje me njëzërit në rrezik poshtë digës, etj.

Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) dhe SKDM i rekomandoi antareve të KKDM të mos miratojnë Projekt Idene e paraqitur për shkak të mungesave të paraqitura me sipër dhe mosplotësimin të kërkesave të legjislativës në fuqi dhe të KKDM. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të mos miratojnë Projekt Idene për Rikonstruksionin e Digës së Rezervuarit Tufinës për shkak të mosplotësimin të kërkesave të legjislativës në fuqi, kushteve aktualeve të mosfunksionimit të digës prej më se 15 vitesh, humbjes së funksionit kryesor të digës, mangësi të konstatuara në studimet mbështetëse për ceshtjet e Sizmikes, gjeologjisë dhe gjeoteknikës si dhe mangësi në lidhje me sistemet e monitorimit, matjeve batimetrike të rezervuarit dhe studimit për karrieraeve të parashikuara



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

2- Ti kërkoj Bashkisë Tiranë

- Te rishikoj studimet mbështetese për Gjeologjinë dhe Gjeoteknikën e zonës në përputhje me kushtet aktuale dhe udhëzimeve të KKDM të shprehura në Vendimin Nr. 15, datë 15.02.2021. Te kryejë matjet batimetrike dhe të paraqesë studimin përkatës për vendet e karrierave dhe për njërezit në rrezik duke u bazuar në llogaritjen e vales vershuese dhe në hartat e permbytjeve për zonat poshtë digës
- Te shqyrtoj versionin e dekomisionimit të digës duke qenë se nga studimet e mëprashme dhe inspektimet në terren, rezultoi se kjo digë ka humbur funksionin kryesor për ujitjen e tokave bujqësore dhe kupa e rezervuarit është mbushur me materiale të ngurta në një shkallë të tillë që objekti ka humbur funksionin
- Te parashikoj në projekt idene e paraqitur sistemet e nevojshme të monitorimit të digës në kushtet aktuale si dhe kushtet e dekomisionimit të digës të shprehura në VKM përkatëse të lartepërmendur.
- Te plotësoj dokumentacionin e projekt idese për rikonstruksionin e digës së Tufines në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi të përmendura në këtë Vendim dhe të shprehet në lidhje me domosdoshmerinë dhe efektivitetin e një projekti të ri për rikonstruksionin e kësaj dige apo dekomisionimit të saj për shkak të humbjes së funksionit kryesor për ujitje.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

